PYETJET E HARTËS SË GJURMUESIT
Tremujori i 1-rë

Të njohim librat e Biblës
Qëllimi: T'i mësojmë nxënësit si të shqiptojnë dhe si të mësojnë përmendsh librat e Biblës, dhe të mësojnë gjithashtu fakte bazë rreth saj.

Vazhdoni të përsërisni deri te një libër specifik dhe pastaj lejojini nxënësit të thonë librin e radhës.

Shembuj:
- Mateu, Marku, Luka, _____
- Mateu, Marku, Luka, Gjoni, Veprat, Romakëve, _____
- Zanafilla, Eksodi, Levitiku, Numrat, _____
- Zanafilla, Eksodi, Levitiku, Numrat, Ligji Përtërirë, Jozueu, Gjyqtarët, Ruthi, _____

Shembuj pyetjesh:
- Bibla është e ndarë në dy pjesë kryesore. Cilat janë ato? (Dh.V dhe Dh.R)
- Sa libra janë në Bibël? (66)
- Sa e vërtetë është Fjala e Perëndisë: vetëm disa pjesë të caktuara të saj apo është e gjitha? (E gjitha është vërtetë!)

Dh.V. dhe Dh.R. – Vendndodhja specifike në Bibël
Qëllimi: T'i sfidojmë nxënësit të mendojnë se cilët libra të Biblës gjenden në Dhiatën e Vjetër dhe cilët në Dhiatën e Re.

Shembuj:
- Mateu është në _____. (Dh.R.)
- Jona është në _____. (Dh.V.)
- Ezekia është në _____. (Nuk është libër i Biblës)

Libri pa fjalë – Përputhja e fjalëve kyç me ngjyrat
Qëllimi: Të prezantojmë Librin pa fjalë përmes ngjyrave kyç.

Shembuj pyetjesh:
- Cila ngjyrë na kujton se Perëndia na do dhe po përgatit një vend për ne? (E arta.)
- Si quhet vendi që po përgatitet? (Qiell.)
- Çfarë do të jetë e ndërtuar me ar në parajsë? (Rrugët.)
- Si të bën të ndihesh fakti që Perëndia i universit të do?

- Cila faqe na kujton se ne të gjithë kemi mëkatuar? (E zeza.)
- Çfarë është mëkati? (Çdo gjë që mendojmë, që themi ose që bëjmë, të cilat janë kundër Perëndisë.)
- Pse është kaq i rëndë mëkati? (Një nga shumë përgjigjet...: ai na ndan nga Perëndia.)

- Cila ngjyrë na kujton Jezusin? (E kuqja.)
- Pse? (Për shkak të gjakut të Tij.)
- Pse është kaq e rëndësishme? (Është e vetmja mënyrë për të shpëtuar nga mëkati.)

- Cila faqe na kujton se jemi falur për mëkatin? (E bardha.)
- Përse? (Na është hequr ndëshkimi.)
- Si ndihesh për faktin që të janë falur mëkatet?

- Cila ngjyrë na kujton të rritemi frymërisht? (Jeshilja.)
- Përse? (Bari, pemët etj., rriten siç duhet të rritemi ne.)
- Më jep një shembull të mënyrave si mund të rritesh. (Duke lexuar Biblën, duke marrë pjesë në kishë, duke ndaluar e duke menduar për atë që ke mësuar etj.)

12 vargjet kyç të Zbuluesit – Përfundo vargun

Qëllimi: Të prezantojmë para nxënësve 12 vargjet kyç të Zbuluesit.
Përsëritja e vargjeve është shumë e rëndësishme për fëmijët. Shënim: Në fillim të tremujorit, nxënësve do t'u duhet ta dëgjojnë vargun thuajse deri në fund që të plotësojnë vendin bosh. Pastaj, përgjatë tremujorit, mund të hiqen më shumë fjalë që ata duhet t'i plotësojnë.

- Romakëve 3:23: "Sepse të gjithë kanë mëkatuar dhe nuk e arrijnë lavdinë e _____." (Perëndisë)
- Gjoni 3:16: "Sepse Perëndia e deshi aq botën, sa dha Birin e tij të vetëmlindurin, që, kushdo që beson në të, të mos humbasë, por të ketë _____." (jetën e përjetshme)
- Fjalët e Urta 3:5-6: "Ki besim tek Zoti me gjithë zemër dhe mos u mbështet në mençurinë tënde; pranoje në të gjitha rrugët e tua dhe ai do të drejtojë _____." (shtigjet e tua)
- Gjoni 14:2: "Në shtëpinë e Atit tim ka shumë banesa; përndryshe do t'ju thosha: po shkoj t'ju përgatis një_____." (vend)
- Jozueu 1:9: "A nuk të urdhërova unë? Ji i fortë dhe trim; mos ki frikë dhe mos u thyej, sepse Zoti, Perëndia yt, është me ty kudo që të _____." (shkosh)
- 2 e Pjetrit 3:18a: "Por rrituni në hirin dhe në njohjen e Zotit dhe të Shpëtimtarit tonë _____." (Jezu Krisht)
- Gjoni 14:6: Jezusi i tha: "Unë jam udha, e vërteta dhe jeta; askush nuk vjen tek Ati përveçse nëpërmjet _____." (meje)
- Hebrenjve 9:22b: "Dhe pa derdhur gjak nuk ka_____." (ndjesë)
- Veprat e Apostujve 16:31: Dhe ata i thanë: "Beso në Zotin Jezu Krisht dhe do të shpëtohesh ti dhe _____ . (shtëpia jote)
- Efesianëve 2:8-9: "Sepse, me anë të hirit jeni të shpëtuar, nëpërmjet besimit; dhe kjo jo prej jush, por është dhurata e Perëndisë, jo prej veprave, që askush të mos_____." (mburret)
- 1 e Korintasve 15:58: "Prandaj, o vëllezërit e mi të dashur, qëndroni të fortë e të patundur, duke tepruar përherë në veprën e Zotit, duke e ditur se mundi juaj nuk është i kotë në_____." (Zotin)
- Marku 12:30-31: Dhe: "Duaje Zotin, Perëndinë tënd, me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd, me gjithë mendjen tënde e me gjithë forcën tënde!". Ky është i pari urdhërim. Dhe i dyti i ngjan këtij: "Duaje të afërmin tënd porsi vetveten". Nuk ka urdhërim tjetër më të madh se _____." (këto)